

VENDIM
Nr. 374, datë 20.5.2026

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 651, DATË 10.11.2017, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR DISPOZITAT ZBATUESE TË LIGJIT NR. 102/2014, ‘KODI
DOGANOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË’”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 9, 10, 18, 19, 24, 26, 29, 35, 39 deri 42, 47, 51, 58, 62, 64, 71, 83, 94, 98, 100, 108, 115, 118, 119, pika 7, 123, 129, 133, 141, 145, 148, 149 deri 152, 153, pikat 1, 2 e 3, 154, 160 deri 169, 174 deri 177, 181, 184, 188, 190, 193, 196, 200, 202, 206, 209, 212, 226, 238, 240, 245, 248, 286, 287 dhe 288, të ligjit nr. 102/2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 616, i vendimit nr. 651, datë 10.11.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr.102/2014, ‘Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë’”, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 616

Plumbosja si masë identifikuese

(Nenet 173, 174, shkronja “a”, e pikës 3, të nenit 203, shkronja “a”, e pikës 2, të nenit 204, nenet 241 dhe 242 të Kodit)

1. Autoritetet doganore, për qëllime identifikimi, paprekshmërie dhe gjurmueshmërie të mallrave të vendosura nën procedurën e transitit, eksportit dhe rieksporit, mund të përdorin plumbçe mekanike, plastike, me tel lidhës dhe plumbçe elektronike, në përputhje me vlerësimin e riskut dhe nevojat e kontrollit doganor.

2. Kur mallrat do të vendosen nën procedurën e transitit, zyra doganore e nisjes plumbos:

a) hapësirën që mban mallrat, kur mjetet e transportit ose kontejneri është i pranuar nga zyra doganore e nisjes si i përshtatshëm për plumbosje;

b) çdo paketim individual, në raste të tjera.

3. Zyra doganore e nisjes regjistron numrin e plumbçeve dhe numrin identifikues të çdo plumbçeje në sistemin elektronik të transitit.

4. Plumbosja elektronike përbën një masë identifikuese që realizohet nëpërmjet një sistemi elektronik, i cili mundëson gjurmimin dhe monitorimin e mallrave, mjeteve të transportit dhe/ose njësive të ngarkesës gjatë lëvizjes së tyre nën mbikëqyrje doganore.

5. Varësisht nga zgjidhjet teknike, sistemi i plumbosjes elektronike mund të përbëhet nga njësi funksionale, të cilat përfshijnë, në mënyrë të ndarë, njësinë qendrore dhe njësinë elektronike mbyllëse periferike (plumbçe elektronike) ose një njësi e vetme që përmbush karakteristikat e përcaktuara në pikat 6 dhe 7, të këtij neni.

6. Njësia qendrore përmbush karakteristikat teknike, si më poshtë vijon:

a) Vepron si pika kryesore e komunikimit ndërmjet pajisjeve të tjera dhe Qendrës së Kontrollit, duke mundësuar gjurmimin GPS;

b) Instalohet dhe fiksohet me një kabllo sigurie të lidhur në pjesën e sipërme të pajisjes.

7. Njësia elektronike mbyllëse periferike (plumbçe elektronike) përmbush karakteristikat teknike, si më poshtë vijon:

a) Ndan dhe transmeton informacionin thelbësor, veçanërisht në lidhje me statusin e plumbçes, duke treguar nëse është e hapur apo e mbyllur;

b) Instalohet në pjesën e jashtme të mjetit transportues ose kontejnerit për të siguruar mbylljen e mjetit të transportit ose kontejnerit apo valvulave të ndarjeve dhe kapakëve të sipërm të cisternës, duke përdorur kabllot e saj të integruara fiksuese;

c) Disponon një modul *software*-ik të sistemit, të aksesueshëm si në versionin *online*, ashtu edhe përmes aplikacionit mobil, në mënyrë që t'i mundësojë përdoruesve:

i. të regjistrojnë në sistem të dhënat e transportit, si: emrin e kompanisë, drejtuesin e mjetit, llojin e mjetit, rimorkion, pikat sipas zonave të lejuara të lëvizjes dhe itineraret;

ii. të caktojnë, paraprakisht, plumçet elektronike për udhëtime specifike;

iii. të monitorojnë dhe të gjurmojnë alarmet gjatë të gjithë udhëtimit, përfshirë tentativat për manipulim të plumbçes ose devijimet nga itinerari i autorizuar;

iv. të mbyllin zyrtarisht lëvizjet e mjetit në sistem pas përfundimit të tyre.

8. Pajisjet dhe sistemi i plumbosjes elektronike duhet të instalohen dhe të përdoren në mënyrë që të garantojnë integritetin e tyre gjatë të gjithë kohëzgjatjes së transportit dhe të sigurojnë funksionimin e pandërprerë të gjurmimit e të transmetimit të të dhënave.

9. Furnizimi me plumbçe elektronike dhe infrastruktura e nevojshme për administrimin e plumbosjes elektronike janë e drejtë ekskluzive e shoqërisë shtetërore “ALBTrace Co” sh.a.”.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Albana Koçiu